

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit B.L, nga ..., për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.1 të KPK-ës sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.2925/2010 të datës 06.10.2010, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Sahide Sefa, të akuzuarit dhe përfaqësuesit të AKP-ës zyrës regjionale në ..., F.P, me date 02.02.2016 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.L, nga i ati Q.. dhe nëna M.. e lindur ..., i lindur me datë ... në fshatin ..., Komuna e ..., tani jeton në ..., rruga "...", nr. ..., ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i martuar, baba i tre fëmijëve, gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 01.08.2010, në ... i akuzuari me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ja merr pasurinë e luajtshme tjetrit duke hapur hapësirat të mbyllura me forcë, në atë mënyrë që shfrytëzon momentin e volitshëm, mos prezencën e personave të tjerë, duke hapur me forcë dritaren e zyrës të udhëheqësit të repartit të dëmtuarës NTSH "...", nga ku ka depërtuar brenda në objekt, dhe pastaj duke thyer dyert të reparteve të tjera ka marr gjësende – metalet të çmuara në një sasi të pa përcaktuar, vlera e të cilave po ashtu është pa përcaktuar, dhe pastaj pa u vërejtur është larguar nga vendi i ngjarjes, ku është hasur nga ana e zyrtarëve policor me datën 11.08.2010, rrugën për në fshatin ..., gjegjësisht në fshatin ..., me sasinë e bakrit dhe telave që kanë qenë diku rreth 50 kg.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 të KPK-ës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 43 par.1 pika 1.2, 45, 73, 74, 75 dhe 76 të KP-ës, te akuzuarit i shqipton:

DENIM ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 05.10.2010 deri me datën 18.11.2010,

E dëmtuara AKP, Zyra regjionale në ..., për realizimin e kërkesës pronësoresh juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të ekspertizës të ekspertit ekonomik financiar shumë prej 163,52 Euro, dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.2925/2010 të datës 06.10.2010, kundër të akuzuarit B.L, nga ..., për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.1 të KPK-ës.

Prokurori i shtetit Sahide Sefa, në fjalën e saj përfundimtare deklaron: që bënë precizimin e aktakuzës, dhe atë sa i përket vlerës të dëmit të shkaktuar të dëmtuarës ashtu që pjesa hyrëse e aktakuzës PP.nr.2925/2010 të datës 06.10.2010 mbetet e pa ndryshuar, sikurse edhe dispozitivi në fillimin e saj, ndërsa sa i përket gjësëndeve të marura, si dhe vlerës të të njëjtave, shton që sendet janë të pa përcaktuara, e po ashtu edhe vlera e tyre, andaj dispozitivi i precizuar i aktakuzës së cekur duhet të jetë: se me datë 01.08.2010, në Prizren i akuzuari me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ja merr pasurinë e luajtshme tjetrit duke hapur hapësirat të mbyllura me forcë, në atë mënyrë që shfrytëzon momentin e volitshëm, mos prezencën e personave të tjerë, duke hapur me forcë dritaren e zyrës të udhëheqësit të repartit të dëmtuarës NTSH "...", nga ku ka depërtuar brenda në objekt, dhe pastaj duke thyer dyert të reparteve të tjera ka marr gjësënde – metalet të çmuara në një sasi të pa përcaktuar, vlera e të cilave po ashtu është pa përcaktuar, dhe pastaj pa u vërejtur është larguar nga vendi i ngjarjes, ku është hasur nga ana e zyrtarëve policor me datën 11.08.2010, rrugën për në fshatin ..., gjegjësisht në fshatin ..., me sasinë e bakrit dhe telave që kanë qenë diku rreth 50 kg.

Në bazë të gjitha shkresave dhe provave të lëndës dhe atë dëgjimit të zyrtarëve të dëmtuarës "...", drejtorëve të reparteve të caktuara, si dhe në bazë të raporteve vjetore gjegjësisht regjistrimit vjetor tek e dëmtuara, e po ashtu edhe gjatë dëshmisë në cilësinë të dëshmitarit të ekspertit ekonomik financiar B.I, të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk është mundur të vërtetohet në tërësi as sasia e sendeve të vjedhura tek NTSH "...", e as vlera e tyre, andaj vetëm sa i përket sendeve dhe vlerave të tyre të cekura në ekspertizën e ekspertit financiar, sasia e sendeve, lloji metaleve dhe vlera e tyre nuk ka mundur të përcaktohet në mënyrë të saktë, ngase e dëmtuara nuk ka bërë regjistrimit e rregullt vjetor që nga viti 2009, andaj tek e dëmtuara nuk janë përpiluar asnjëherë asnjë lloji regjistrimi, për dëmet eventuale që janë shkaktuar të njëjtës, përkundër asaj që edhe sipas deklaratave të zyrtarëve të dëmtuarës NTSH "...", të dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve gjatë shqyrtimit gjyqësor deklarojnë që disa herë ka ndodhur vjedhje dhe nuk kanë përpiluar kurrfarë raporti, lidhur me këtë dhe lidhur me lëshimet në regjistrimet vjetore siç ka deklaruar edhe eksperti ekonomik financiar, pa këto raporte nuk mund të vërtetohet as sasia, as lloji e as vlera e sendeve të vjedhura. Nga të gjitha këto nuk është kontestuese që i pandehuri B.L ka kryer veprën penale të vjedhjes të rëndë, ashtu siç është përsëritur edhe në dispozitivin e precizuar sot në shqyrtimin gjyqësor, ngase në vend të ngjarjes janë gjetur gjurmët

e gishtërinjve, të cilat gjurmë të gishtërinjve janë këtu të pandehurit, e cila gjurmë është vërtetuar edhe në bazë të mendimit dhe konstatimit të ekspertit të daktiloskopisë të parashtruar kësaj gjykate si provë dhe ate nr. ... të datës 06.10.2010, provë kjo e cila edhe është administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, e cila e vërteton edhe faktin që këtu i pandehuri ka qenë në ditën kritike dhe ka kryer veprën penale e cila i vihet në barë në bazë të aktakuzës të precizuar sot në shqyrtimin gjyqësor, për çka gjykatës i propozoj që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës AKP zyra regjionale në Prizren F.P, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: i bashkëngjitëm veprës penale dhe i mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit si dhe parashtrajtje të kërkesës pronësore juridike, për lartësinë të cilës shumë do të deklarohej dhe sqarohemi në kontestin të rregullt civil.

I akuzuari B.L, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: edhe një herë si në shqyrtimin e kaluar, edhe sot në shqyrtimin gjyqësor gjatë tërë procedurës, konsideroj dhe mendoj që me asnjë provë nuk është vërtetuar vepra penale e cila më vihet në barë, unë është e vërtetë që kam qenë në vend të ngjarjes tek oborri i NTSH "...", dhe është e vërtetë që kam marr një sasi të telit të bakrit dhe telit tjetër në formë të metalit, për të cilat kam qenë interesuar që të njëjtat ti shesë, kur edhe jam hasur nga ana e zyrtarëve të policisë. Është fakt që unë jam hasur me telin e bakrit dhe me telin të llojit të metalit në fshatin ... duke shkuar për në fshatin ..., për këtë e kam bërë që të shes të njëjtat në ndonjë punishte apo hekurishte për mbledhjen e hekurishteve. Nëse tërë këtë që deklaroja, dhe gjatë tërë procedurës, gjykata gjen që në veprimet e mia ekziston ndonjë element i veprës penale që më vihet në barë, i propozoj gjykatës që të ketë parasysh të cekurat më lart, moshën time në kohën e kryerjes kësaj vepre eventuale, se tani jam person familjar, baba i tre fëmijëve, dhe me punën time kohë pas kohshme kujdesem për sigurimin e ekzistencës të familjes time.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 01.08.2010, në ... i akuzuari me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ja merr pasurinë e luajtshme tjetrit duke hapur hapësirat të mbyllura me forcë, në atë mënyrë që shfrytëzon momentin e volitshëm, mos prezencën e personave të tjerë, duke hapur me forcë dritaren e zyrës të udhëheqësit të repartit të dëmtuarës NTSH "...", nga ku ka depërtuar brenda në objekt, dhe pastaj duke thyer dyert të reparteve të tjera ka marr gjësende – metalet të çmuara në një sasi të pa përcaktuar, vlera e të cilave po ashtu është pa përcaktuar, dhe pastaj pa u vërejtur është larguar nga vendi i ngjarjes, ku është hasur nga ana e zyrtarëve policor me datën 11.08.2010, rrugën për në fshatin ..., gjegjësisht në fshatin ..., me sasinë e bakrit dhe telave që kanë qenë diku rreth 50 kg.

Gjykata pas vlerësimit të gjitha shkresave dhe provave të lëndës dhe ate deklaratave të akuzuarit, dëshmitarëve R.Q, N.M, Xh.G.1, Xh.Z, B.S, N.H, G.H, Sh.J, V.M, Z.Sh, Xh.G.2, A.K, si dhe të ekspertit ekonomik financiar B.I, provave materiale dhe ate ekspertizës me shkrim të ekspertit ekonomik financiar, të datës 17.08.2015, raportit të mendimit të ekspertit të daktiloskopisë, Njësia ... në ... të datës 06.10.2010, si dhe në bazë të shkresave tjera përcjellëse të lëndës ka ardhur në përfundim se i akuzuari B.L, me datën 01.08.2010, në ... me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, ka marr pasurinë e luajtshme tjetrit, duke e hapur hapësirat e mbyllura me forcë, në atë mënyrë që shfrytëzon momentin e volitshëm, mos

prezencën e personave tjerë, duke hapur me forcë dritaren e zyrës të udhëheqësit të repartit të dëmtuarës NTSH "...", nga ku ka depërtuar brenda në objekt, dhe pastaj duke thyer dyert e reparteve tjera ka marr gjësede – metalet të çmuara në një sasi të pa përcaktuar, vlera e të cilave po ashtu është e pa përcaktuar, dhe pa u vërejtur është larguar nga vendi i ngjarjes, ku është hasur nga ana e zyrtarëve policor me datën 11.08.2010, rrugës për në fshatin ..., gjegjësisht në fshatin ... me sasinë e bakrit dhe telave që kanë qenë diku rreth 50 kg, e të gjitha këto me qëllim të përfitimit jo proporcional, dhe këtë e ka kryer me dashje sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta dhe ka dëshiruar kryerjen e saj si dhe shkaktimin e pasojës. Pra në rastin konkretë gjykata në këtë mënyrë edhe ka vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike. Nga kjo del se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.1 të KPK-ës.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarit R.Q, i cili në shqyrtimin gjyqësor me datë 03.02.2015 deklaroi: Mbes në tërësi si në deklaratën e dhënë me datën 18.11.2010, pranë kësaj gjykate, dhe nuk kam tjetër çka të shtoj. Në ditën kritike kam vërejtur xhamin e thyer, i cili është larg prej tokës rreth 2 metra, dhe me të vërejtur kemi ftuar drejtoreshën N.H. Me datën 30.07.2010, së bashku me njësit e policisë, të cilat i ka ftuar kolegu im N.M, dhe së bashku me drejtoreshën, dhe kolegun Xh.G., kemi vërejtur si ceka më lartë xhamat e thyer, si dhe kemi vërejtur 5 apo 6 thasë të mbushura me mesing, dhe ate në kuadër të kompleksit të ndërmarrjes "...", në drejtim të fabrikës së duhanit. Nuk mund të deklarohej, ngase nuk di se kush ka mundur ti ketë përgatitur ashtu të paketuara, dhe cili ka qenë qëllimi i paketimit të këtyre thasëve, të akuzuarin e njoh nga shqyrtimi i kaluar.

Dëshmitari N.M, në shqyrtimin gjyqësor me datën 03.02.2015, deklaroi: Në tërësi qëndroj pranë deklaratës të dhënë në shqyrtimin e datës 18.11.2010, pranë kësaj gjykate, dhe nuk kam tjetër çka të shtoj. Ndërrimin e kam marr rreth orës 18,00, dhe në momentin kur kam shkuar për ti dhezuar dritat në repart, pasi që ka filluar të errësohej, kam vërejtur dy persona, dhe ate njëri ka qenë brenda objektit, ndërsa tjetri ka qenë jashtë, të dy personat kanë qenë të armatosur me arma të ftohta, dhe ate personi që ka qenë jashtë ka pasur në dorë një thikë, ndërsa personi që ka qenë brenda, ka qenë i pajisur me një shufër metalike. Si më kanë vërejtur të dyshuarit, janë vërsulur në drejtimin tim, më kanë kanosur dhe ate njëri me thikë e tjetri me shufër metalike. Pas kësaj unë kam shkuar ta njoftoj kolegun tim Xh.G., i cili ka qenë te porta kryesore, dhe së bashku me Xh., jemi kthyer në vend të ngjarjes, dhe e kemi njoftuar policinë. Dua të theksoj që në moment kur jemi kthyer, në vende të ngjarjes, nuk kanë qenë personat që i përmenda më lart, të njëjtit ishin larguar. Derisa ka ardhur policia, jemi ndalur dhe kemi kontrolluar edhe një herë hapësirat e kompleksit, dhe në një pjesë ku gjenden disa thera, në oborr të kompleksit, kemi hasur 5 thasë të mbushura me mesing, dhe të cilat kanë qenë gati për tu bartur. Vendi ku kanë qenë thasët, është afër skajit të oborrit të kompleksit, nga ku nuk ka dalje nga kompleksi, por në rrethojën e kompleksit, e cila është në formë të gardhit, është formuar një vrimë me madhësi ku mund të kaloj një njeri, të cilën vrimë nuk e di se kush e ka bërë, dhe nga aty janë bartur sendet e ndryshme, këtë e them se me rastin e ardhjes së policisë, së bashku me kolegun tim, dhe drejtoreshën e ndërmarrjes, me rastin e kontrollimit detal të kompleksit, kemi vërejtur disa copa të metaleve të ndryshme të rënë për tokë, të cilat mund të bijnë gjatë bartjes. Theksoj edhe një herë se këto mbetje kanë qenë jashtë rrethojës së kompleksit të fabrikës. Nuk mund të deklarohej konkretisht për afërsinë, e di që kanë qenë shumë afër, nuk kam mundur ti identifikoj, ngase nga frika pasi që kanë qenë me thikë dhe me shufër metalike si ceka më lart,

mund të them lirisht që nuk kam mundur ti identifikoj nga frika për sigurim timin personale. Të akuzuarin e njoh nga shqyrtimi i kaluar.

Dëshmitari Xh.G.1, në shqyrtimin gjyqësor me datë 27.02.2015, deklaron: Në tërësi qëndroj pranë deklaratës të dhënë edhe në shqyrtimin e më hershëm gjyqësorë në këtë çështje penale me datë 18.11.2010, dhe përsëris që rojtari N.M, i ka hasur dy persona, të cilët kanë ikur , ndërsa materiale i cili është tentuar të mirët nga ana e të njëjtëve ka mbetur në tentativë, nga se të njëjtit kanë ikur, ndërsa materialin e kanë lënë në hapësirat e fabrikës. Kjo ka ndodhur me datë 30.07.2010. Ndërsa të nesërmen, pra me datë 01.08.2010, në ndërmarrje për prodhimin e duhanit është hyrë dhe kanë kaluar në repartin e elektro kontakteve, me të cilin rast janë nxjerrë një sasi e materialeve të ndryshme dhe ate: mesing i profileve të ndryshme, bakër , plumb, argjend , dhe me datën 01.08.2010 nga ana e rojtarit të cekur është njoftuar edhe drejtori N.H, si dhe udhëheqësi i rojeve R.Q. Konsideroj se sasia e gjithmbarshme e sendeve të vjedhura peshon diku rreth 5 tonë, dhe ate profileve të ndryshme, të cilat mund të jenë bartë me karrocë dorë për dore deri te rruga kryesore dhe ate në vazhdim si për disa ditë. Po ashtu theksoj që në objekt ka roje , dhe ate 24 orë , dhe punohet me ndërrime çdo 8 orë, bëhet ndërrimi i rojtarit. Theksoj që në ditën kur ka ndodhur rasti me 01.08.2010 rrojtat ka qenë N.M, i cili ka njoftuar drejtorin e atëhershëm të ndërmarrjes, dhe udhëheqësin e rojeve, për ate që ka hasur, si përshkrova më lartë. Dëmin e kemi vlerësuar në bazë të përpilimit të raportit të komisionit profesional, i cili raport është përbërëse e shkresave të lëndës. Raporti ku e ka vlerësuar komisioni këtë shumë është raport i përpiluar me një periudhë të pacaktuar, nuk është i kufizuar vetëm për datat 30.07.2010 dhe 01.08.2010. Në bazë të raportit të përpiluar me datë 02.03.2010, nga ana e kolegjiutit profesional, me datën 06.08.2010. Raportin e ka kërkuar drejtori i ndërmarrjes N.H. Raporti është përpiluar për vjedhjen e shkaktuar në ndërmarrjen tonë e që është objekt i kësaj çështje penale. Mund të jetë ndonjë gabim teknik në pyetje , kur është fjala për datën e përpilimit të raportit, dhe i njëjti raport është i protokolluar me nr.04/2 të datës 06.08.2010.

Dëshmitari Xh.Z, në shqyrtimin gjyqësor me datë 27.02.2015, deklaron: Unë kam punuar në cilësinë e rojtarit pranë ndërmarrjes “...” në ..., me datën 01.08.2010, kur është shkaktuar vepra penale kam qenë në vendin e punës prej orës 07,00 të mëngjesit deri në orën 19,00 të njëjtës ditë, dhe me këtë orë e kam dorëzuar ndërrimin tim rojtarëve-kolegëve Xh.G nga fshati ... Komuna e ..., dhe N.M nga fshati... Komuna e Për rastin e ndodhur kam kuptuar tek pas tre dite, dhe ate pasi që ka ardhur policia në shtëpinë time , nga se unë kam pas pushim dy ditë, pas punës kur e kam dorëzuar ndërrimin tim kolegëve ashtu si ceka më lartë, pasi që ka përfunduar ndërrimi im, e kam nënshkruar edhe raportin e dorëzimit pranimi të ndërrimit, ku dorëzohet ndërrimi dhe paraqitet gjendja e lënë. Unë gjatë ndërrimit tim nuk kam vërejtur asnjë mangësi në ndërmarrje.

Dëshmitari B.S, në shqyrtimin gjyqësor me datë 27.02.2015, deklaron: Unë më ditën kritike kur ka ndodhur rasti , kam qenë në pushim vjetorë, por ditën e nesërme me datë 02.08.2010, më ka ftuar drejtori për ta zëvendësuar në ndërrimin e parë kolegun tim Sh. B, dhe kur kam arritur në ndërmarrje, jam njoftuar dhe kam kuptuar që ka ardhur deri te një vjedhje një natë më përpara, andaj unë edhe pse nuk kam qenë në punë, pasi që kam qenë në pushim vjetor,

jam paraqitur në punë për zëvendësim të kolegut sipas kërkesës të drejtorit. Drejtoresha e ka njoftuar policinë ka ardhur policia , dhe ka vazhduar punën e saj.

Dëshmitarja N.H, në shqyrtimin gjyqësor me datën 29.04.2015, deklaroi, Është e vërtetë që me datën 01.08.2015, në fabrikën e atëherëshme “...” ka ndodhur një vjedhje, dhe se me datën e njëjtë tek ne në fabrikë kanë ardhur zyrtarët policor të cilët na kanë njoftuar për vjedhjen e kryer. Të njëjtit na kanë urdhëruar që të përpilojmë një procesverbal lidhur me sasinë e sendeve dhe gjërave që mungon dhe vlerën e të njëjtave. Unë në atë kohë kam qenë ushtruese e detyrës të drejtorit dhe kam mbledhur një komision në përbërje prej 8 personave dhe kemi përpiluar raportin me datën 02.08.2010 dhe qëndroj në tërësi pranë të njëjtit.

Mundet me qenë një gabim teknik me rastin e shtypjes së datave gjegjësisht përpilimit e raportit me shkrim, dhe atë duhet të qëndroj data 02.08.2010 e jo data 02.03.2010, kjo nga fakti që kemi filluar regjistrimin e sendeve të nesërmen nga dita e rastit të ndodhur gjegjësisht të vjedhjes. Sa i përket datës së shënuar në këndin e djathtë të lart të raportit dhe atë data 06.08.2010, deklaroj që kjo datë është datë e dorëzimit të raportit, andaj përfundimisht duhet të qëndroj ashtu siç deklaroj sot në shqyrtimin e sotëm gjyqësor. Arsyeja ka qenë si ceka më lart kërkesa e policisë pas vjedhjes së kryer, pra ka qenë e thjeshtë edhe për të konstatuar dëmet e mjeteve dhe mungesën e tyre në fabrikë.

Mua më ka njoftuar në natën kritike dëshmitari – rroja N.M, dhe unë menjëherë jam paraqitur në hapësirat e fabrikës, dhe këtu i njëjti më ka njoftuar që është tentuar të kryhet vjedhja një natë më herët se që është në aktakuzë kur është kryer vepra penale e vjedhjes. Dëshiroj të theksoj që një natë më përpara pra me datë 30.07.2010 është tentuar vjedhja, por e njëjta ka mbetur vetëm në tentativë, ngase është vërejtur nga roja, ndërsa me datë 01.08.2010 është kryer vepra penale e vjedhjes, por të njëjtën ne nuk e kemi vërejtur, ngase kur kemi arritur në vend të ngjarjes kemi vërejtur vetëm pasojat e saj. Pushimi pa pagesë ka qenë prej datës 01.07.2010 dhe kemi planifikuar deri me datën 01.09.2010, këtë lloj pushimi pa pagesë e kemi bërë për shkak të vëllimit të ulët të punëve. Datat dhe periudhat kohore nuk kanë qenë të caktuara paraprakisht, theksoj që këto janë varur nga vëllimi i punëve, e sa i përket vitit 2010 kjo ka qenë në muajin korrik dhe gusht si theksova më lart.

Gjendja ka qenë normale kur e kemi lënë ne dhe kemi shkuar në pushim pa pagesë, të gjitha mjetet të cilat janë regjistruar në raport kanë qenë në hapësirat e fabrikës, konkretisht në repartin ... dhe ..., e kur kemi përpiluar raportin të njëjtat kanë munguar. Edhe gjatë pushimit me pagesë ka qenë rroja e angazhuar, dhe atë tërë kohën sipas orarit të tyre.

Raporti i përpiluar me të gjitha gjësendet e theksuara e të cilat mungojnë fjala është për datën 01.08.2010, raporti është përpiluar me datën 02.08.2010, dhe i njëjti ka përfunduar me datë 06.08.2010, të gjitha sendet, mjetet sa i përket sasisë dhe vlerës janë si në raportin e cekur.

Duke pasur parasysh peshën e sendeve që mungojnë, nuk besoj që të njëjtat mund të barten për një ditë dhe atë nga një person. Nuk mund të deklarohem lidhur me atë se sa kohë duhet që të barten të gjitha sendet që figurojnë në raport, ngase nuk ka mundësi dhe njohuri për të vlerësuar kohë zgjatjen për bartjen e sendeve.

Ushtruese e detyrës drejtoreshës jam emëruar në vitin 2007, muaji nuk më kujtohet, pasi që ka kaluar një kohë e gjatë dhe të njëjtën detyrë e kam ushtruar deri në privatizim të fabrikës me datë 11.09.2011. gjatë kësaj kohe kemi përpiluar raporte të zakonshme vjetore në fund të vitit kalendarik. Secili punëtor në pozitat e përgjegjësve kanë qenë të ngarkuar me një sasi të caktuar të mjeteve të punës, konkretisht ndonjë raport të posaçëm nuk e kemi përpiluar, pos atyre raporteve si ceka në fund të vitit kalendarik. Po ashtu theksoj që fabrika “...” dy herë ka qenë në procedurë të privatizimit, dhe dy herë më përpara ka dështuar para se të privatizohet me datë 11.09.2011 dhe të gjithë dokumentacionin për dy privatizime paraprake të dështuara lidhur me gjendjen e fabrikës i kemi dorëzuar në AKP.

Dëshmitari G.H, në shqyrtimin gjyqësor me datën 04.06.2015, deklaron: unë kam qenë i punësuar në NSH “...”, që nga janari i vitin 1981 deri në ditën e privatizimit, konkretisht me datën 11.09.2011, konkretisht me datën 11.09.2011 kam punuar në shumë vende të punës në ndërmarrje, e së fundi kam qenë drejtor teknik. Kolegjiumi ka qenë i formuar për evidentimin e dëmit material të shkaktuar me rastin e vjedhjes të ndërmarrjes në vitin 2010, këtë kolegjiun e ka formuar ushtruesi i detyrës së drejtorit, në të cilin kolegjiun kanë qenë të përfshirë të gjithë drejtorët e reparteve dhe sektorëve tjerë që kanë ushtruar veprimtarin në kuadër të NSH “...”, dhe unë kam qenë i emëruar si drejtori teknik i fabrikës. Vlerësimin e dëmeve e kemi bërë në këtë raport, si ceka për shkak të vjedhjes. Në kohën kur është shkaktuar vjedhja në fabrikë, ka qenë numri i vogël i punëtorëve, ngase ka qenë periudha kur ndërmarrja jonë ka qenë në procedurë të privatizimit, e kësajsoj edhe afarizmi ka qenë pak i stagnuar. Me rastin e vjedhjes, ne punëtorët që kemi qenë ende në marrëdhënie pune kemi formuar kolegjiun, me të vetmin qëllim që të regjistrohet dhe të vlerësohet dëmi i shkaktuar ndërmarrjes. Veprimet konkrete në këtë regjistrim kanë qenë vizita e reparteve secilës veç e veç, ngase fabrika jonë ka qenë e përbërë prej 5 njësi- reparteve, dhe secili repart ka pasur përgjegjësin e vet – menaxherin. Në kohën dhe vendin ku është shkaktuar vepra penale, është konstatuar që kjo vjedhje është shkaktuar në repartin e materialeve elektro kontakteve, ku ka pasur gjysëm prodhime elektro materiale dhe prodhimet e gatshme. Kolegu im Sh.J ka qenë përgjegjës i këtij reparti. Qëndroj në tërësi si në peshë ashtu edhe në vlerësimin material të përpiluar në raport. Regjistrimet e gjendjes së mjeteve dhe vlerësimin e tyre material me anë të regjistrimit e përpilojnë në fund të vitit kalendarik dhe më së largu në mes të muajit janar të vitit vijues të njëjtat i përfundojmë. Sa i përket raporteve të gjitha pasi që kemi përfunduar i kemi dorëzuar AKP-ës dhe këtë që nga viti 2002 së pari AKM-ës e pastaj pas vitit 2008 – 2009 AKP-ës si trashëgimtar juridik të AKM-ës, dua të theksoj edhe faktin që raporti i kolegjiun të datës 06.08.2010 ka qenë raport i jashtë zakonshëm, e i cili është përpiluar pas vjedhjes në fabrikë.

Dëshmitari Sh.J, në shqyrtimin gjyqësor me datë 04.06.2015, deklaron: unë kam qenë punësuar në NSH “...” që nga korriku i vitit 1977, deri në ditën e privatizimit e ndërmarrjes në vitin 2011, konkretisht me datën 11.09.2011, kam punuar në shumë vende të punës në ndërmarrje , e së fundi kam qenë administrator i repartit i materialeve elektro kontaktuese, pikërisht repart ky edhe ku ka ndodhur vjedhja e shkaktuar me datë 01.08.2010. kolegjiun ka qenë i formuar për evidentimin e dëmit material të shkaktuar me rastin e vjedhjes të ndërmarrjes në vitin 2010. Këtë kolegjiun e ka formuar ushtruesi i detyrës së drejtorit, në të cilin kolegjiun kanë qenë të përfshirë të gjithë drejtorët e reparteve dhe sektorëve tjerë që kanë ushtruar veprimtarin në kuadër të NSH “...”, dhe unë kam qenë i emëruar si administrator i repartit të materialeve elektro kontaktuese. Vlerësimin e dëmeve e kemi bërë në këtë repart, sikurse edhe në

të gjitha repartet tjera. Në kohën kur është shkaktuar vjedhja në fabrikë, reparti të cilin unë e kam administruar ka qenë i mbyllur, sa i përket veprimtarisë të ushtruar, ngase kemi qenë në procedurë të privatizimit dhe ne kemi qenë në marrëdhënie të punës, por në muajin majë ne kemi shkuar në shtëpi dhe nuk jemi paraqitur në punë, ngase kemi qenë për shkak të pasivitetit të veprimtarisë për shkaqe që i ceka më lart, kemi qëndruar në shtëpi. Me rastin e vjedhjes, ne punëtorët që kemi qenë ende në marrëdhënie pune, e kemi formuar kolegjiun, me të vetmin qëllim të regjistrohet dhe të vlerësohet dëmi i shkaktuar ndërmarrjes. Veprimet konkrete në këtë regjistrim kanë qenë vizita e reparteve secilës veç e veç, ngase fabrika jonë ka qenë e përbërë prej 5 njësive – reparteve, dhe secili repart ka pasur përgjegjësin e vet – menaxherin. Në kohën dhe vendin ku është shkaktuar vepra penale, është konstatuar që kjo vjedhje është shkaktuar në repartin e materialeve të elektro kontakteve, ku ka pasur gjysëm prodhime elektro materiale dhe prodhimet e gatshme. Unë kam qenë administrator i këtij reparti dhe kemi bërë regjistrimin e mjeteve të munguara dhe vlerësimin material të tyre, në krahasi me regjistrimin e fundit. Qëndroj në tërësi pranë raportit të përpiluar nga ana e kolegjiun profesional si në peshë ashtu në vlerësimin material të përpiluar në raport. Regjistrimet e gjendjes së mjeteve dhe vlerësimin e tyre material me anë të regjistrimit e përpilojmë në fund të vitit kalendarik dhe më së largu në mes të muajit janar të vitit vijues të njëjtat i përfundojmë. Sa i përket këtyre raporteve të gjitha ato përfundimtare i përfundojmë pasi që paraprakisht secili repart veç e veç e përpilon raportin mbi gjendjen e mjeteve dhe këtë gjendje të mjeteve të gjetura me anë të regjistrimit i dërgojmë sektorit të financave për ta bërë vlerësimin material të të njëjtave, dhe me këtë përfundon puna ima nën përgjegjësit e mia. Raportin mbi gjendjen e mjeteve të repartit të cilin unë e kam udhëhequr, e kam përpiluar çdo tre muaj dhe atë përfundimtarin në fund të vitit kalendarik. Është një periudhë e gjatë kohore, nuk më kujtohet për momentin, por sa i përket periudhës janar qershor 2010, në rast se e kanë përpiluar, të njëjtin si ceka më lart i kemi dorëzuar sektorit të financave për vlerësimin material të mjeteve.

Dëshmitari V.M, në shqyrtimin gjyqësor me datë 04.06.2015 deklaroi: unë kam qenë i punësuar në NSH “...” që nga muaji mars i vitit 1987, deri në ditën e privatizimit e ndërmarrjes në vitin 2011, konkretisht me datën 11.09.2011, kam punuar në shumë vende të punës në ndërmarrje, e së fundi kam qenë udhëheqës i sektorit të thikëtarisë, reparti nr.1. kolegjiun ka qenë i formuar për evidentimin e dëmeve material të shkaktuar me rastin e vjedhjes së ndërmarrjes në vitin 2010. Kush e formoi këtë kolegjiun unë nuk e di, ngase ka kaluar një kohë e gjatë, por e di që në këtë kolegjiun kanë qenë të përfshirë të gjithë drejtorët e reparteve dhe sektorëve tjerë që kanë ushtruar veprimtarin në kuadër të NSH “...”, dhe unë kam qenë i emëruar si udhëheqës në sektorin e thikëtarisë. Vlerësimin e dëmeve e kemi bërë në këtë repart sikurse edhe në të gjitha repartet tjera. Në kohën kur është shkaktuar vjedhja në fabrikë, reparti në të cilin unë e kam administruar ka qenë i mbyllur, sa i përket veprimtarisë të ushtruar, ngase kemi qenë në procedurë të privatizimit dhe ne kemi qenë në marrëdhënie të punës por në muajin maj ne kemi shkuar në shtëpi dhe nuk jemi paraqitur në punë, ngase kemi qenë për shkak të pasivitetit të veprimtarisë për shkaqet që i ceka më lart, kemi qëndruar në shtëpi. Me rastin e vjedhjes, ne punëtorët që kemi qenë ende në marrëdhënie të punës e kemi formuar kolegjiun, me të vetmin qëllim të regjistrohet dhe të vlerësohet dëmi i shkaktuar ndërmarrjes. Veprimet konkrete në këtë regjistrim kanë qenë vizita e reparteve secilës veç e veç, ngase fabrika jonë ka qenë e përbërë prej 5 njësive – reparteve dhe secili repart ka pasur përgjegjësin e vet menaxherin. Në kohën dhe vendin kur është shkaktuar vepra penale, është konstatuar që kjo vjedhje është shkaktuar në repartin e materialeve të elektro kontakteve, ku ka pasur gjysëm prodhime elektro

materiale dhe prodhimet e gatshme. Të gjithë anëtarët e komisionit në fillim kemi bërë vizitë tërë hapësirës së fabrikës dhe pastaj kemi bërë regjistrimin e mjeteve të munguara dhe vlerësimin material të tyre në krahasim me regjistrimin e fundit. Qëndroj në tërësi pranë raportit të përpiluar nga ana e kolegjiut profesional si në peshë ashtu edhe në vlerësimin material të përpiluar në raport. Regjistrimet e gjendjes të mjeteve dhe vlerësimin e tyre material me anë të regjistrimit e përpilojmë në fund të vitit kalendarik dhe më së largu në mes të muajit janar të vitit vijues të njëjtat i përfundojmë. Sa i përket këtyre raporteve të gjitha ato përfundimtare i përfundojmë pasi që paraprakisht secili repart veç e veç e përpilon raportin mbi gjendjen e mjeteve dhe këtë gjendje të mjeteve të gjetura me anë të regjistrimit i dërgojmë sektorit të financave për ta bërë vlerësimin material të të njëjtave dhe me këtë përfundon puna ime në përgjegjësit e mia.

Dëshmitari Z.Sh, në shqyrtimin gjyqësor me datë 04.06.2015, deklaron: Unë kam qenë i punësuar në NSH “...” që nga viti 1968 e deri në ditën e privatizimit e ndërmarrjes në vitin 2011, konkretisht me datën 11.09.2011, kam punuar në shumë vende të punës, në ndërmarrje e së fundi kam qenë udhëheqës i repartit të sanitarisë. Kolegjiut ka qenë i formuar për evidentimin e dëmit material të shkaktuar me rastin e vjedhjes së ndërmarrjes në vitin 2010. Kolegjiut e ka formuar ushtruesja e drejtorit në atë kohë, në këtë kolegjiut kanë qenë të përfshirë të gjithë drejtorët e reparteve dhe sektorëve tjerë që kanë ushtruar veprimtarin në kuadër të NSH “...”, dhe unë kam qenë i emëruar si udhëheqës i repartit të sanitarisë. Vlerësimin e dëmeve e kemi bërë në këtë repart, sikurse edhe në të gjitha reparte tjera. Në kohën kur është shkaktuar vjedhja në fabrikë, repartin të cilin unë e kam administruar ka qenë i mbyllur sa i përket veprimtarisë të ushtruar, ngase kemi qenë në procedurë të privatizimit dhe ne kemi qenë në marrëdhënie të punës, por në muajin maj ne kemi shkuar në shtëpi dhe nuk jemi paraqitur në punë, ngase kemi qenë për shkak të pasivitetit të veprimtarisë për shkaqe që i ceka më lart kemi qëndruar në shtëpi. Me rastin e vjedhjes, ne punëtorët që kemi qenë ende në marrëdhënie pune e kemi formuar kolegjiutin, me të vetmin qëllim të regjistrohesh dhe të vlerësohet dëmi i shkaktuar në ndërmarrje. Veprimet konkrete në këtë regjistrim kanë qenë vizita e reparteve secilës veç e veç, ngase fabrika jonë ka qenë e përbërë prej 5 njësive – reparteve dhe secili repart ka pasur përgjegjësin e vet – menaxherin. Në kohën dhe vendin ku është shkaktuar vepra penale është konstatuar që kjo vjedhje është shkaktuar në repartin e materialeve elektro kontakteve, ku ka pasur gjysëm prodhime elektro materiale dhe prodhimet e gatshme. Të gjithë anëtarët e komisionit në fillim i kemi bërë vizitë tërë hapësirës së fabrikës dhe pas kësaj kemi bërë regjistrimin e mjeteve të munguara dhe vlerësimin material të tyre në krahasim me regjistrimin e fundit. Po qëndroj pranë raportit të përpiluar si në peshë ashtu edhe në vlerësimin material të përpiluar në raport. Regjistrimet e gjendjes së mjeteve dhe vlerësimin e tyre material me anë të regjistrimit e përpilojmë në fund të vitit kalendarik dhe më së largu në mes të muajit janar të vitit vijues të njëjtat i përfundojmë. Sa i përket këtyre raporteve të gjitha ato përfundimtare i përfundojmë pasi që paraprakisht secili repart veç e veç e përpilon raportin mbi gjendjen e mjeteve dhe këtë gjendje të mjeteve të gjetura me anë të regjistrimit i dërgojmë sektorit të financave për ta bërë vlerësimin material të të njëjtave dhe me këtë përfundon puna ime në përgjegjësit e mia.

Dëshmitari Xh.G.2, në shqyrtimin gjyqësor me datë 04.06.2015, deklaron: Unë kam qenë i punësuar në NSH “...” që nga viti 1962 deri në ditën e privatizimit të ndërmarrjes në vitin 2011, konkretisht me datën 11.09.2011, kam punuar në shumë vende të punës në ndërmarrje, e së fundi kam qenë udhëheqës i mirëmbajtjes. Kolegjiut ka qenë i formuar për evidentimin e dëmit

material të shkaktuar me rastin e vjedhjes së ndërmarrjes në vitin 2010. Kolegjiumin e ka formuar drejtori i atëhershëm sipas detyrës zyrtare, por e di që në këtë kolegjiun kanë qenë të përfshirë të gjithë drejtorët e reparteve dhe sektorëve tjerë që kanë ushtruar veprimtarinë në kuadër të NSH "...", dhe unë kam qenë i emëruar si udhëheqës i sektorit të mirëmbajtjes. Vlerësimin e dëmeve e kemi bërë në këtë repart, sikurse edhe në të gjitha repartet tjera. Në kohën kur është shkaktuar vjedhja në fabrikë, reparti të cilin unë e kam administruar ka qenë i mbyllur, sa i përket veprimtarisë të ushtruar, ngase kemi qenë në procedurë të privatizimit dhe ne kemi qenë në marrëdhënie të punës, por në muajin maj, ne kemi shkuar në shtëpi dhe nuk jemi paraqitur në punë, ngase kemi qenë për shkak të pasivitetit të veprimtarisë për shkaqet si ceka më lart, kemi qëndruar në shtëpi. Me rastin e vjedhjes, ne punëtorët që kemi qenë ende në marrëdhënie pune e kemi formuar kolegjiun me të vetmin qëllim të regjistrohet dhe të vlerësohet dëmi i shkaktuar ndërmarrjes. Veprimet konkrete në këtë regjistrim kanë qenë vizita e reparteve secilës veç e veç, ngase fabrika jonë ka qenë e përbërë prej 5 njësive – reparteve dhe secili repart ka pasur përgjegjësin e vet – menaxherin. Në kohën dhe vendin ku është shkaktuar vepra penale, është konstatuar që kjo vjedhje është shkaktuar në repartin e materialeve elektro kontakteve, ku ka pasur gjysëm prodhime elektro materiale dhe prodhimet e gatshme. Të gjithë anëtarët e komisionit në fillim kemi bërë vizitë të hapësirës së fabrikës dhe pastaj kemi bërë regjistrimin e mjeteve të munguara dhe vlerësimin material të tyre në krahasim me regjistrimin e fundit. Qëndroj në tërësi pranë raportit të përpiluar si në peshë ashtu edhe në vlerësimin material të përpiluar në raport. Regjistrimet e gjendjes së mjeteve dhe vlerësimin e tyre material me anë të regjistrimit të përpiluar në fund të vitit kalendarik dhe më së largu në mes të muajit janar të vitit vijues të njëjtat i përfundojmë. Sa i përket këtyre raporteve të gjitha ato përfundimtare i përfundojmë pasi që paraprakisht secili repart veç e veç e përpilon raportin mbi gjendjen e mjeteve dhe këtë gjendje të mjeteve të gjetura me anë të regjistrimit i dërgojmë sektorit të financave për ta bërë vlerësimin material të të njëjtave dhe me këtë përfundon puna ime në përgjegjësit e mia.

Dëshmitari A.K, në shqyrtimin gjyqësor me datë 25.06.2015, deklaroi: Unë kam qenë i punësuar në NSH "...", që nga data 06.06.1978, deri në momentin e privatizimit të ndërmarrjes në vitin 2011, konkretisht me datën 11.09.2011, me përjashtim të një periudhe 4 vjeçare 1995-1999, ku për shkak të masave të dhunshme kam qenë i pushuar nga marrëdhënia e punës. Në momentin e kryerjes së veprës penale në ndërmarrjen tonë, konkretisht me datën 01.08.2010, kam qenë duke punuar në ndërmarrje në cilësinë e drejtorit financiar. Për shkak të vjedhjes në fabrikën tonë, kemi qenë të lajmëruar së pari nga roja e objektit, i cili i pari ka vërejtur që në hapësirat e ndërmarrjes mungon një sasi e bakrit, dhe nga kjo mungesë i njëjti e ka bërë vëzhgimin e vendit të ngjarjes, dhe në hapësirat për rreth vendit ku ka qenë bakri, është vërejtur edhe që dyert e hapësirave përcjellëse të objektit ku ka qenë i vendosur materiali i ndryshëm për nevojat e fabrikës, të njëjtat kanë qenë të hapura, dhe është konstatuar që mungon sasi shumë ma e madhe e materialit pos atij të bakrit. Këtë vëzhgim roja i objektit R.Q. e ka bërë së bashku me ish ushtruesin e detyrës të drejtoreshë N.H, andaj në bazë të kësaj, drejtoresha ka vendosur që të formoj një kolegjiun profesional, për të përpiluar një raport, lidhur me materialin që mungon në fabrikë. Ky kolegjiun profesional është përbërë nga drejtorët e Departamenteve apo resorëve të fabrikës tonë, dhe pasi që unë si ceka më lart kam qenë drejtor financiar, edhe unë kam qenë anëtar i këtij kolegjiuni.

Regjistrimin e kemi bërë varësisht nga lloji dhe vlera e materialit, konkretisht për argjend dhe prodhimet e argjendit kemi bërë herën e fundit me datën 31.05.2010, ndërsa për materiale tjera kemi bërë regjistrime në fund të vitit kalendarik. Sa i përket materialit argjendit i njëjti ka qenë i vendosur në dy vende, dhe ate gjysëm prodhimet e bakrit kanë qenë në një depo, ndërsa prodhimet e gatshme kanë qenë në një depo tjetër. Të dy depot kanë qenë me dyert të hapura. Ceka më lart që regjistrimi është bërë në çdo fund vit, për vitin paraprak, dhe regjistrimi i fundit është bërë në fund të vitit 2009, por më konkretisht mund të vërtetohet në bazë të raporteve që ne i kemi dërguar AKP-ës, pasi që ka qenë periudhë kur ndërmarrja jonë ka qenë në procedurë të privatizimit, dhe e njëjta ka qenë nën mbikëqyrje të AKP-ës, të gjitha raportet qofshin ato mujore, apo vjetore ne të njëjtat i kemi dorëzuar AKP-ës, andaj me siguri të njëjtit i posedojnë raportet tona. Sa i përket regjistrimit argjendit, ate jam i sigurt që regjistrimi i fundit për sasinë e argjendit ka qenë me datë 31.05.2010, por prapë se prapë theksoj që AKP-ja i ka të gjitha raportet tona deri në privatizimin e plotë në muajin shtator të vitit 2011. Ruajtja e objektit dhe e depove si pjesë përcjellëse të objektit ka qenë në ruajtje 24 orë pa ndërprerë dhe ate nga dy roje në çdo ndërrim nga 8 orë. Nuk ma merr mendja se tërë ky material mund të dal pa u vërejtur nga askush nga hapësirat e ndërmarrjes, edhe pse nuk jam ekspert në këtë lami.

Eksperti ekonomik financiar B.I në shqyrtimin gjyqësor me datën 05.11.2015 deklaroi: Me rastin e shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, lidhur me këtë ekspertizë sqaroj që artikujt të paraqitura në tabelën në faqe 3 dhe 4 të ekspertizës, vetëm artikujt nën 2 dhe ate 200 kg tel bakri FI 1.88 me çmim prej 8 Euro dhe në vlerë të përgjithshme prej 1.600 Euro si dhe artikulli nën 3 po të njëjtës tabelë dhe ate tel bakri në sasi prej 30 kg me çmim prej 8 Euro në vlerë të përgjithshme prej 240,00 Euro, konsideroj që kanë qenë artikuj të marr nga këtu i akuzuari, pasi që të njëjtat sipas shkresave të lëndës janë gjetur tek i akuzuari. Këtë konstatim e bazoi në faktin që me rastin e shqyrtimit këtë fakt e kam hasur në shkresat e lëndës, ku të njëjtit i janë gjetur në posedim sasia prej 50 kg tel bakri. Ky konstatim përputhet edhe me sasinë e raportit si material i munguar tek e dëmtuara ish "...", dhe artikujt tjerë të cekur, nuk janë hasur tek i akuzuari. Po kam analizuar dhe ate me shumë përkushtim. Në përshkrimin tim në paragrafin e cituar, kam ardhur në përfundim dhe konstatim që nga praktika ime e deri tashme në këtë lëmi si profesionist, regjistrimet e artikujve duhet të bëhen në fund të vitit kalendarik, me përjashtime të rasteve të ndodhura siç është ky, duhet të formohet edhe komisioni prej 3 anëtarëve, dhe ky komision duhet të pajiset me vendime dhe materiale shtesë, si nga kontabiliteti, po ashtu edhe nga depot, dhe në këtë mënyrë të bëhet dallimi në mes të regjistrimit të fundit dhe regjistrimit fizik. Kjo mënyrë, nuk ka ekzistuar në rastin konkret. Këtë e mbështes në faktin që komisioni vlerësues për dëmin e shkaktuar të dëmtuarës ka qenë ekip i përbërë nga 8 persona, dhe në atë raport të përpiluar nga rastet e vjedhjes të ndodhur me datë 01.08.2010, në ndërmarrjen ish "...", të datës 06.08.2010, nuk përshkruhet koha se kur ka qenë regjistrimi i fundit. Përfundimi i kësaj vjen që sasia e munguar në NTSH "...", dhe ate në peshë prej 5.245 tonë, është sasi e munguar për një kohë të gjatë, andaj nga kjo edhe kam cituar ashtu siç e kam përshkruar në paragrafin 2 të faqes 5 të ekspertizës time me shkrim. Do të ishte shumë profesionale po të përgatitej çdo vite raporti, dhe të gjeturat me regjistrimin fizik të datës 01.08.2010, të përshkruheshin lidhur me gjendjen fizike që nga regjistrimi i fundit. Nuk është bërë regjistrimi, së paku nga shkresat që i kam pasur në dispozicion, por vetëm është bërë një raport me datën 06.08.2010, në përbërje prej 8 anëtarëve të kolegjiut profesional. Ky raport përshkruan artikujt e munguar në NTSH "...", e kjo nga librat e kontabilitetit që i ka poseduar e dëmtuara. Kjo nuk korrespondon me profesionalizëm dhe me gjendjen faktike të kërkuar, kur e them këtë e bazoj në ato artikuj të cilat

mungojnë, e të cilat pretendohen që janë marr me datë 01.08.2010. nga kjo është e pa imagjinuar që tërë kjo mangësi e artikujve të cekur në këtë raport, të mungojnë për një kohë të shkurtër, e aq më pak për një ditë, e tërë këtë të vihet në barë një personit. Kjo diferencë është në përlllogaritje, si rezultat i llogaritjes aritmetike, drejtori bashkë me stafin e vet punuese kanë konstatuar se vjedhja ka ndodh brenda 3-4 orëve, por sipas deponimeve ata mendojnë se mund të ketë zgjatur më shumë se një ditë.

Edhe më lart ceka, por edhe tani po them, që duhet paraprakisht të bëhet regjistrimi në çdo fund vit të artikujve të mbetura. Procedura e tij regjistrimi bëhet në mënyrë që bëhet regjistrimi fizik, i të gjithë artikujve, ky vendim gjegjësisht regjistrim tek e dëmtuara nuk kanë bërë në vitin paraprak, pra për vitin 2009. Po të kishte pasur regjistrim dhe prova të regjistrimit për vitin 2009, që do të ishte bërë në fund të këtij viti, do të ishte mundësia që të bëhej krahasimi me artikujt e mbetur me datë 01.08.2010, kur ka ndodhur vjedhja te e dëmtuara. Nga kjo nuk ka kurrfarë përputhje dhe krahasimi me artikujt e mbetur në datën e vjedhjes. Kolegjiumi profesional është dashur ta dinë fare mirë pasi në atë përbërje ka qenë edhe drejtori financiar, të marr vendim lidhur me regjistrimin e jashtë zakonshëm të mjeteve themelore, pajisjeve, materialit dhe të bënë krahasimin të vitit 2009 me raportin e viti 2010 kur ka ndodhur rasti dhe në atë regjistrimit të jetë evidenca e saktë duke përfshirë emërtimin, sasinë, çmimin dhe vlerën e nënshkruar nga llogari dhënësit e depove respektivisht të reparteve ku ka ndodhur mungesa dhe të vërtetuara nga përgjegjësi e komisioni prej 3 anëtarëve. Nga shkresat e lëndës nuk kemi dokumentacion adekuat, por figuron vetëm regjistrimi i vitit 2004, dhe të vitit 2010, se nuk ka kurrfarë përputhshmërie as sa i përket çmimit, sasisë, dhe vlerës së tregut, kjo ka ndodhur për shkak të si ceka më lart të neglizhencës.

Mendimi im përfundimtar, në bazë të ekspertizës me shkrim të parashtruar, deklaratës sime sot në shqyrtim gjyqësor, konsideroj dhe mendoj që barrë e mungesës të artikujve tek e dëmtuara mund të jenë vetëm dy artikuj, dhe ate artikujt nën 2 dhe 3 të tabelës në faqen 5 të ekspertizës, siç theksova edhe në fillim të deklaratës sime.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 10.12.2015 është bërë edhe shikimi dhe leximi i mendimit dhe konstatimit të ekspertit të daktiloskopisë nr. ... të datës 06.10.2010.

I akuzuari B.L, në shqyrtimin gjyqësor me datë 05.01.2016, në mbrojtën e vet deklaroi: Që në ditën kritike është e vërtet që kam marr disa sasi të telit të bakrit, të cilat i kam parë në oborrin e fabrikës të ish ndërmarrjes "...", në ... sasia ka qenë shumë e vogël, nuk mund të skjarohem se sa, dhe të njëjtën sasi ma ka marr policia me rastin e hasjes ime në fshatin ..., rrugës për në fshatin Sasinë e bakrit, dhe telat që kanë qenë sipas mendimit tim diku rreth 50 kg, që mi kanë hasur në automjet, policia mi ka marr. Këto artikuj unë e pranoj që i kam marr, dhe ate pasi që të njëjtat kanë qenë si të hedhura në oborr të fabrikës. Unë sasinë e bakrit që kam pasur me veti, të cekur më lart e kam pasur për qëllim që ta shes. Kam provuar në ... që ti shes një depoje për sende të vjetra të përdorura të quajtur "...", por të njëjtit nuk kanë pranuar që të i blejnë me arsyetim që nuk e kam pasur letërnjoftimin me veti, ndërsa për këtë arsye jam nisur në fshatrat rreth ... për të tentuar që ti shes, kam provuar në ..., por pa sukses, andaj kam vazhduar për në fshatrat tjera, dhe rrugës jam hasur nga policia. E di vetëm që lokali i fabrikës ka qenë pa rrethoja. Ka qenë ora 09,00-09,30 minuta, pra ditë, dhe unë me karrocën time i kam vërejtur telat e bakrit dhe i kam vendosur në karrocë. Brenda nuk kamë hyrë, jam afruar deri te dritaret e

objektit, të cilat kanë qenë të thyera. Jo nuk e di nga cila anë kam hyrë, ngase në hapësirat e objektit kanë qenë disa ndërtesa, ndërsa unë vetëm çka kam gjetur në oborr tela të bakrit, të njëjtat i kam vendosur në karrocë. Gjurmët e gishtërinjve të mija janë gjetur si theksova më lart që unë kam arritur deri te xhamat e objektit, dhe në këtë mënyrë edhe e kam prekur, e kjo ekziston që të njëjtat kanë mbetur si shenja në xhama, gishtërinjtë e mi respektivisht gjurmët. Xhamat i kam prekur ndoshta duke shikuar brenda në objekt. Nuk e di dhe nuk më kujtohet qëllimi dhe arsyeja e saktë se pse i kam prekur, por theksoj edhe një herë që unë kam shëtitur sa më kujtohet në oborr të fabrikës diku rreth një orë, për të mbledhur sende, gjë sende të ndryshme, të cilat më kanë dukur që janë të mundshme të shitën në depot e ndryshme, kryesisht telat e bakrit e të ngjashme. Në shtëpinë time janë konfiskuar vetëm një parë këpuca, të cilat nuk e di se kujt kanë qenë, as që kam pasur njohuri që kanë qenë në shtëpinë time. Po ashtu këtë nuk e ka ditur askush nga anëtarët e familjes, pos djalit tim, i cili gjatë mbjelljes të mbeturinave, sendeve të metalit gjegjësisht kanaçe të pijeve, i ka hasur të njëjtat dhe i ka sjellur në shtëpi, vlen të theksohet që unë në momentin e bastisjes gjegjësisht kontrollimit nga ana e zyrtarëve policor, as një send – artikull nga fabrika “...” nuk ka qenë në shtëpinë time. Pos telave të bakrit që më janë hasur në automjet, siç theksova më lart asnjë artikull e asnjë send tjetër nga këto të munguara në fabrikën “...” nuk janë hasur tek unë. Atletet që janë konfiskuar nga policia, e të cilat janë hasur në shtëpinë time kanë qenë të djalit, të cilat i njëjti i ka gjetur gjatë mbledhjes të mbeturinave. Unë theksova edhe më herët, edhe tani theksoj që për çështjen e atleteve kam kuptuar në ditën kur më është bastisur shtëpia, nuk e kam ditur që të njëjtat kanë qenë tek shtëpia ime, këtë e kam kuptuar pasi që më ka njoftuar djali, dhe i njëjti më ka thënë që atletet e cekuar i ka gjetur tek kontejnerët tek qendra tregtare ish “...” në Nuk e di dhe nuk mund të them asgjë lidhur me këtë, por e di që numri i këmbës ime është 43, ndërsa patikat të cilat janë gjetur gjurmët në vend të ngjarjes kanë qenë me numër 40. Nuk e di saktë se sa ka kaluar koha nga dita kur të njëjtat i kam marr, e deri në momentin kur jam hasur nga zyrtarët policor në fshatin ... si ceka më lart. E di që një kohë nuk mund të shkjarohem se sa telat e bakrit i kam lënë, tek hekurudhat, por sa saktësisht ka qenë kjo periudhë, nuk mund të di, pasi që ka kaluar një kohë e gjatë. Për numrin 40 të atleteve të gjetura në vend të ngjarjes, gjegjësisht gjurmëve, më kanë njoftuar policia, e cila në momentin e gjetjes të njëjtave më ka ofruar që të njëjtat ti mbathi, por unë kam provuar por nuk kam mundur, ngase kanë qenë të vogla në krahasim me madhësinë e këmbës sime, ngase unë e kam numrin 43, aty policia më ka njoftuar që atletet e hasura kanë qenë me numër 40.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar në bazë të deklaratës të akuzuarit, ekspertit ekonomik financiar B.I, në të cilën deklaratë eksperti ekonomik financiar përshkruar në mënyrë të detajuar se sende gjegjësisht artikujt të cilët janë të paraqitura në tabelën në faqen 3 dhe 4 të ekspertizës vetëm artikujt nën 2 dhe ate 200 kg tel bakri FI 1.88 me çmim prej 8 Euro dhe në vlerë të përgjithshme prej 1.600 Euro si dhe artikujt nën 3 po të njëjtës tabelë dhe ate tel bakri në sasi prej 30 kg me çmim prej 8 Euro në vlerë të përgjithshme prej 240 Euro, konsideron që janë marr nga këtu i akuzuari, pasi që të njëjtat sipas shkresave të lëndës janë gjetur tek i akuzuari. Po ashtu i njëjti ka sqaruar edhe faktin se shuma e pretenduar për dëmin e shkaktuar të dëmtuarës prej 54.153,80 Euro nuk ka mundur të argumentohet me dokumentet profesionale, ngase regjistrimet e artikujve duhet të bëhen në fund të vitit kalendarik, duhet të formohet edhe komisioni prej 3 anëtarëve, dhe ky komision duhet të pajiset me vendimet dhe materiale shtesë, si nga kontabiliteti po ashtu edhe nga depot dhe në këtë mënyrë të bëhet dallimi në mes të regjistrimit të fundit dhe regjistrimit fizik. Këtë e ka mbështetur edhe në faktin që komisioni vlerësues për dëmin e shkaktuar të dëmtuarës ka qenë ekip i përbërë prej 8 persona, dhe në raport

të përpiluar për rastin e vjedhjes të ndodhur me datën 01.08.2010, në raportin e datës 06.08.2010, nuk përshkruhet koha se kur ka qenë regjistrimi i fundit, andaj ka ardhur në përfundim se sasia në peshë prej 5.245 është e munguar për një kohë të gjatë, andaj edhe nga kjo mund të vërtetohen që sendet që pretendohen që i ka marr këtu i akuzuari janë sendet të cekura më lart, të cilat janë gjetur të njëjtit. Do të ishte shumë profesionale po të përgatitej çdo ditë raporti, dhe të gjeturat në regjistrimin fizik të datës 01.08.2010, të përshkruheshin lidhur me gjendjen fizike që nga regjistrimi i fundit. Raporti i përpiluar nga ana e kolegjiut prej 8 anëtarëve nuk korrespondon me profesionalizëm dhe me gjendjen faktike të kërkuar, ngase është e pa imagjueshme që tërë kjo mangësi i artikujve të cekur në këtë raport të mungoj për një kohë të shkurtër, e aq më pak për një ditë, e tërë kjo ti vihet në barë një personi. Mendimi përfundimtar i ekspertit është që të akuzuarit mund të vihet në barë vetëm dy artikuj dhe ate artikuj nën 2 dhe 3 të tabelës në faqen 5 të ekspertizës. Po ashtu gjykata vërtetoi që nuk është kontestuese ekspertiza e shenjave të gishtërinjve gjegjësisht ekspertiza e daktiloskopisë, ku janë gjetur gjurmët e gishtërinjve të akuzuarit në vendin e ngjarjes, ashtu siç përshkruhet në konstatimin me shkrim të mendimit të ekspertit të daktiloskopisë, ku vërtetohet që gjurma e vijave papilare e tërhequr nga vendi i ngjarjes, është identike me shenjën e gishtit tregues me numrin 2 të dorës të djathtë të akuzuarit.

Nga të cekurat më lartë, në mënyrë të qartë dhe të drejt vërtetohet gjendja faktike që në veprimet e të akuzuarit paraqiten të gjitha elementet e veprës penale të vjedhjes së rëndë, kjo nga fakti që gjurmët e gishtërinjve të gjetura në vend të ngjarjes, dhe ekzaminimi i tyre është identike me gishtin tregues të akuzuarit. Sa i përket deklaratës të vetë të akuzuarit të dhënë në mbrojtjen e vet në shqyrtimin gjyqësor, gjykata nuk ja fali besimin sa i përket deklaratës të tij në drejtim të asaj që telat që ju gjetën të njëjtit dhe ate telat e bakrit në sasi prej 50 kg, të njëjtat nuk i ka marr por të njëjtat i ka mbledhur në oborrin e kompleksit të dëmtuarës NT "...", dhe të njëjtat i kishte mbledhur me qëllim që ti shes në hekurishte apo në ndonjë depo për mbledhje të hekurishteve. Po ashtu thekson që nuk ka pasur për qëllim që ato ti merr po të kishte ditur që i takojnë të dëmtuarës, por të njëjtat i ka marr duke menduar se janë të pa nevojshme dhe se janë hedhur si mbeturina. Gjukata një mbrojtje të tillë nuk ja fali besimin, ngase e njëjta ka për qëllim vetëm shmangien nga përgjegjësia penale dhe lirimin e të akuzuarit nga aktakuza. Po ashtu gjykata gjatë shqyrtimit të gjitha provave secilës veç e veç dhe të gjitha në tërësi, dhe ate deklaratave të dëshmitarëve të dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor N.M, R.Q, Xh.G.1, Xh.Z dhe B.S, të cilët kanë qenë rroje tek e dëmtuara, asnjëri nga ta nuk e ka vërejtur këtu të akuzuarin në ditën kritike, dhe të njëjtin e njohin vetëm në shqyrtimin gjyqësor, e po ashtu edhe deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ate N.H, G.H, Sh.J, V.M, Z.Sh, Xh.G.2 dhe A.K, të dëgjuar në cilësinë e dëshmitarëve që kanë qenë zyrtarë të dëmtuarës me rastin e përpilimit të raportit të dëmtuarës lidhur me artikujt dhe dëmin e shkaktuar, nuk kanë mundur në mënyrë të qartë të konstatojnë dhe të vërtetojnë lidhur me sasinë dhe llojin e artikujve të munguar, por në mënyrë sipërfaqësore kanë përshkruar të gjeturat e tyre në ditën kritike, dhe përpilimin e raportit e kanë bazuar nga të gjeturat në vendin e ngjarjes, por pa e specifikuar konkretisht se nga cila datë konkrete ka qenë regjistrimi i fundit deri me datën e përpilimit të raportit për mungesën e artikujve dhe vlerën e tyre. Regjistrimet e të dëmtuarës sipas ekspertit ekonomik financiar janë regjistrime të cilat nuk korrespondojnë me profesionalizëm dhe gjendjen faktike të kërkuar, andaj gjykata të njëjtat nuk mundi ti fal besimin dhe të mbështet në të njëjtat për vërtetimin e gjendjes faktike. Po ashtu nga të cekurat edhe prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare nga tërë të cekurat më lart, ka bërë edhe precizimin e aktakuzës, duke precizuar aktakuzën që këtu i akuzuari me qëllim të përvetësimit të kundër ligjshëm për vete merr pasurinë e luajtshme tjetrit

duke e hapur hapësirat e mbyllura me forcë dritaren e zyrës të udhëheqësit të repartit të dëmtuarës NTSH "...", nga ku ka depërtuar brenda në objekt dhe pastaj duke thyer dyert e reparteve të tjera ka marr gjë sende – metale të çmuara në një sasi të pa përcaktuar, vlera e të cilave po ashtu është e pa përcaktuar dhe pastaj pa u vërejtur është larguar nga vendi i ngjarjes ku është hasur nga ana e zyrtarëve policor me datën 11.08.2010, rrugës për në fshatin ... gjegjësisht në fshatin ..., me sasinë e bakrit dhe telave që kanë qenë diku rreth 50 kg.

Nga të gjitha të cekurat më lart gjykata ka ardhur në përfundim që në veprimet e të akuzuarit janë pësuar elementet e veprës penale të vjedhjes së rëndë, dhe ate nga fakti që është përvetësimi i sendit të huaj në mënyrë të kundër ligjshme, si dhe elementi që ka të bëjë me eliminimin e të gjitha pengesave për përvetësimin e këtij sendi, ku konstatohet që i njëjti ka depërtuar në hapësirat e brendshme të objektit të dëmtuarës me përdorimin e forcës, andaj nga të gjitha këto gjykata gjeti dhe e shpalli fajtor të akuzuarin, ngase i njëjti e ka dashur kryerjen e kësaj vepre, ka qenë i vetë dijshtëm për pasojën që shkakton me veprimet e veta dhe ka dëshiruar kryerjen e saj, pra në rastin konkret gjykata edhe ka vërtetuar përgjegjësin penalë juridike të akuzuarit. Nga kjo del se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.1 të KPK-ës.

Me rastin e marrjes së vendimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, rrethanat familjare të akuzuarit si dhe personaliteti i të njëjtit, konform neni 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar me gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, moshën e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, është person familjar, baba i tre fëmijëve, sjellja e tij pas veprës penale të shkaktoar, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me burgim në kohë zgjatje prej 2 (dy) muajve, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe ate prej datës 05.10.2010 deri me datën 18.11.2010, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës në kontest të rregullt civil, gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.274/2011 me datë 02.02.2016

**Procesmbajtësja
Naxhis Sharani**

**Gjyqtari
Luan Berisha**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.